



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËSË
DHE ENERGJISË

Nr. 5394/prot.

Tiranë, më 24. 3. 2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1328, datë 17.03.2009.

SHOQËRISË "BUNA MAT" SH.P.K
Lagjia e Re, Burrel.

Për dijëni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM**
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Buna Mat" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1328, datë 17.03.2009, për mineral kuarci, në objektin "Kodra e Batrave", Mat.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.5815, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5394, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1328, datë 17.03.2009, për mineral kuarci, në objektin "Kodra e Batrave", Mat, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit vjetor në shumën 876 714 lekë, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31 të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për vitin 2013 dhe 2014.

Propozimi i është dërguar për njoftim edhe shoqërisë tuaj dhe pas marrjes të tij ju keni depozituar pranë institucionit mandat pagesën vetëm për vitin 2017, pagesë të cilën e keni realizuar me datë 05.04.2017. Kështu, mbetet pa u kryer pagesa e garancisë vjetore të rehabilitimit të mjedisit, për vitin 2013 dhe për vitin 2014.

Leja juaj është dhënë në bazë të Ligjit Nr.7796, datë 17.02.1994, "Minerar të Shqipërisë" të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gërmën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për

të cilat një leje revokohet), të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1328, datë 17.03.2009, për mineral kuarci në objektin "Kodra e Batrave", Mat, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes së shfrytëzimit nr.1328, datë 17.03.2009, për mineral kuarci, në objektin "Kodra e Batrave", Mat.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

